VENDIM
Nr. 79, datë 15.3.2023

MBI KËRKESËN E SHOQËRISË "TREN SUN SYSTEM" SHPK PËR MARRJEN E AUTORIZIMIT NGA ERE PËR VENDOSJEN E KUOTAVE TË KAPITALIT, SI MJET PËR GARANTIMIN E PËRMBUSHJES SË DETYRIMIT NDAJ "RAIFFEISEN BANK" SHA

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar; nenit 3 dhe nenit 8 të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e statusit ligjor të të licencuarit, ndryshimin e ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit dhe vendosjen e kuotave/aksioneve të ortakut/aksionerit që kontrollon interesat e të licencuarit si mjete për garantimin e përmbushjes së detyrimit/eve ndaj të tretëve", miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 235, datë 26.11.2021; si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 15.3.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 914/1 prot., datë 13.3.2023, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, "Mbi kërkesën e të licencuarve 'Sun Beat System' sh.p.k., 'Tren Sun System' sh.p.k., 'Erni Solar' sh.p.k., 'Korça Photovoltaic Park' sh.p.k. dhe 'NTSP' sh.p.k., për marrjen e autorizimit nga ERE për vendosjen e kuotave të kapitalit të tyre si mjet për garantimin e përmbushjes së detyrimit ndaj 'Raiffeisen Bank' sh.a.",

konstatoi se:

- Shoqëria "Tren Sun System" sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 915 prot., datë 21.2.2023, ka paraqitur kërkesën për marrjen e autorizimit për vendosjen e kuotave të kapitalit si mjet për garantimin e detyrimeve ndaj "Raiffeisen Bank" sh.a.
- Shoqëria është licencuar në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 192, datë 21.7.2022.
- Marrëveshja e Barrës Siguruese nr. 950 rep, nr. 708 kol., datë 1.3.2022, "Mbi kuotat e pjesëmarrjes në shoqëri", nënshkruar me "Raiffeisen Bank" sh.a. (në cilësinë e barrëmarrësit), e depozituar nga shoqëria në kuadër të marrjes së autorizimit, është nënshkruar përpara se shoqëria të licencohej nga ERE në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike (datë 21.7.2022).
- Për sa më sipër, ERE nuk mund të marrë në shqyrtim këtë kërkesë, për sa kohë marrëdhënia juridike me bankën për vendosje barre siguruese është krijuar përpara se shoqëria të merrte statusin e të licencuarit dhe të lindnin detyrimet përkatëse në kuadër të këtij statusi.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të mos marrë në shqyrtim kërkesën e shoqërisë "Tren Sun System" sh.p.k. për marrjen e autorizimit të ERE-s për vendosjen e kuotave të kapitalit si mjet për garantimin e detyrimeve ndaj "Raiffeisen Bank" sh.a.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara.

Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti